

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

TIRANA PARKING

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Nr. 1011/1 Prot.

Tiranë, më 19/06/2023

Lënda: Kërkohet për publikim të vendeve vakante në Tirana Parking

AGJENSISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Blv. "Bajram Curri"

Tiranë

Në zbatim të VKM me nr.243/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar, kreu II, pika 6 dhe Ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 19, pika 1 dhe 2, Ju dërgojmë kërkesën për publikimin e 1(një) pozicion vend vakant provizor "Përgjegjës Sektori" në institucionin e Tirana Parking.

Bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni shpalljet për:

1. 1(një) vend i lirë pune nivel 'përgjegjës sektori' së bashku me përshkrimin e punës

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Eglantina Zere

Tirana Parking, Bashkia Tiranë

SHPLLJE PËR VËNDE TË LIRA PUNE

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr.7961, dt.12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), Urdhërit nr.28272/1, datë 05.10.2022 "Për miratimin e Strukturës dhe Organikës të Institucionit "Tirana Parking", Institucioni Tirana Parking, shpall procedurat për vendet e lira të punës:

✚ Përgjegjës Sektori, pozicion provizor, kategoria e pagës III-a - I (një)

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të kenë diplomë në arsimin e lartë, sipas profilit të kërkuar;
3. Të kenë të kryer arsimin e mesëm (për profilin);
4. Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe të aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar
5. Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Kërkesë për aplikim;
2. Jetëshkrim;
3. Fotokopje e Kartës së Identitetit;
4. Çertifikatë e përbërjes familjare;
5. Fotokopje e diplomës 4-vjeçare, bachelor, master shkencor dhe lista e notave e noterizuar (për përgjegjësit e sektorëve);
6. Fotokopje e diplomës bachelor dhe master dhe lista e notave e noterizuar (për specialistët);
7. Fotokopje e dëftesës së shkollës së mesme;
8. Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);
9. Fotokopje e librezës së punës;
10. Raport mjeko-ligjor;
11. Vërtetim i Gjëndjes Gjyqësore;
12. Dëshmi Penaliteti;
13. Vërtetim i Prokurorisë;
14. Dy fotografi (2.5 x 3.5cm).

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë në adresën: Rruga "Ali Begeja", Ndërtesa nr.16, Kodi Postar 1017, Tiranë

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar.

Kandidatët në intervistën me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë në lidhje me punën;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për punën.

DALJA E REZULTATEVE DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, institucioni Tirana Parking do të shpallë rezultatet duke i kontaktuar me telefon, si dhe në stendën e njoftimeve.

Për këtë pozicion pune kanë përparësi studentët e ekselencës, bazuar VKM me nr.586, datë 30.08.2019 “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit është data 21.06.2023

